

Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Bashkëpunimin Ndërkufitar –

CBIB, Faza I Drejt Përfundimit!

Të dashur lexues,

Pas një udhëtimi të gjatë e emocionues prej 29 muajsh, faza e parë e CBIB – Cross Border Institution Building (Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Bashkëpunimin Ndërkufitar) është drejt përfundimit. Zyrtarisht projekti do të mbyllet më 22 tetor 2008.

Bashkëpunimi ndërkufitar në bazë të instrumentit të ri financiar të BE-së, IPA, është një proces i komplikuar që po ndodh për herë të parë në 8 kufij të brendshëm të Ballkanit Perëndimor paralelisht. Me qëllim që ky proces të jetë i suksesshëm, është vendosur një mekanizëm efikas rajonal koordinimi, si dhe sinergjitë në të gjitha nivelet. Me punën e madhe dhe përkushtimin e të gjitha Autoriteteve Kombëtare në vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe me drejtimin e vendosur dhe përfshirjen e drejtpërdrejtë të Komisionit Evropian, u përgatitën dokumentet e programimit si baza ligjore për procesin të cilat u aprovuan në dhjetor 2007.

Në vijim, janë ngritur në të gjithë kufijtë Strukturat e Përbashkëta të Menaxhimit, të domosdoshme për programimin efikas dhe efektiv, si dhe menaxhimin e zbatimin e projektit.

Aplikantët Potencialë të IPA CBC janë njoftuar në kohën e duhur në lidhje me pëmbajtjen e programeve dhe mundësitë për financim nëpërmjet fushatës ndërgjegjëse të organizuar nëpër të gjithë Rajonin nga CBIB në bashkëpunim me Autoritetet Kombëtare dhe partnerët e tjerë lokalë e rajonalë.

Në vijim të fushatës ndërgjegjëse dhe me qëllim forcimin e menaxhimit të programit e kapaciteteve zbatuese, si dhe kapaciteteve për përgatitjen e projekteve që do të siguronin përdorimin efikas të fondeve të disponueshme, CBIB ka organizuar një sërë sesionesh trajnimi për përfaqësuesit e institucioneve kombëtare dhe Strukturat e Përbashkëta të Menaxhimit, si dhe për Aplikantët Potencialë.

Të gjitha këto hapa ishin të nevojshme për të ardhur tek e tashmja, një objektiv mjaft i rëndësishëm në proces: lancimi i Thirrjeve për Propozime në të gjithë kufijtë!

Deri më sot është bërë shumë punë. Gjithsesi, programet e suksesshme dhe zbatimi i projekteve janë tashmë sfida më e madhe që shtrohen përpara aktorëve në Rajon të përfshirë në IPA CBC. Për të siguruar që procesi të vazhdojë të ecë në rrjedhën e vet e për të ruajtur rezultatet e fituara gjatë fazës së parë të CBIB, Komisioni Evropian ka vendosur të financojë fazën e dytë të projektit që do të vijojë menjëherë pas përfundimit të fazës së parë. Kjo demonstroi vlerën e shtuar të arritjes së koordinimit dhe bashkëpunimit në nivel rajonal!

Në këtë edicion të CBIB fokus, po ju prezantojmë dy vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk kemi mbuluar deri tani – Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Serbinë (faqet 2-8) – por gjithashtu dëshirojmë t'ju prezantojmë një përmbledhje të veprimtarive të projektit e t'ju tregojmë se cili është ekipi i CBIB që ju mbështeti gjatë të gjithë këtij procesi, i cili me profesionalizëm e besim në një synim të përbashkët, ka treguar se kemi arritur kaq shumë objektiva (faqet 9-14).

Pas fazës së parë të projektit, unë dhe i gjithë ekipi i CBIB do të dëshironim të falënderonim të gjithë partnerët e projektit dhe aktorët e IPA CBC në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për punën e tyre të madhe, mbështetjen dhe përkushtimin për të arritur objektiva të reja të rëndësishme për procesin e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor së bashku!

Natasa Gospodjinacki
Drejtuuese e Ekipit të CBIB

PËRMBAJTJA

Bosnja dhe Hercegovina e Serbia

2/3

Intervistë: Znj. Gordana Lazarevic, Asistente e Ministrit, Ministria e Financave, Republika e Serbisë

Intervistë: Znj. Nada Bojanic, Shefe e Departamentit për CBC, DEI, Bosnja dhe Hercegovina

4/5

Programet e IPA CBC

6

Delegacioni i Komisionit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë

Projekti EU CORIN: Në Mbështetje të Bashkëpunimit Ndërkufitar

7

Agjensitë e Zhvillimit Rajonal në Bosnjë dhe Hercegovinë

8

Përvoja e Vojvodinës në CBC

Partneriteti midis CBIB dhe Projektit 'Rajoni Ekonomik në Ujëndarësin e Savas'

9-14

Forcimi i Kapaciteteve Institucionale për Bashkëpunimin Ndërkufitar



Intervistë: Znj. Gordana Lazarevic, Asistente e Ministrit, Ministria e Financave, Republika e Serbisë



CBIB: Cila është rëndësia e bashkëpunimit ndërkuftar për integrimin evropian të Serbisë?

G.L.: Rëndësia e bashkëpunimit ndërkuftar për integrimin në BE është e shumëllojshme. Së pari, në këtë mënyrë Serbia merr fonde shtesë të cilat mund t'i përdorë për të zgjeruar e forcuar bashkëpunimin me fqinjët, që në të njëjtën kohë janë edhe partnerët e saj kryesorë në tregti, e për të rinovuar të gjitha format e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve lokale, si ndërmjet organeve dhe institucioneve të vetë-qeverisjes lokale, edhe organizatave të shoqërisë civile. Kjo përfaqëson një mbështetje të tërthortë financiare për zonat kufitare, të cilat, si rregull, janë relativisht më pak të zhvilluara ekonomikisht për shkak të afërsisë me kufirin.

Së dyti, këto lloj programesh mundësojnë planifikimin e përbashkët të veprimtarive në fushat që mbulojnë, financimin e përbashkët dhe realizimin e përbashkët të projekteve. Në një perspektivë afatgjatë, CBC përfaqëson një bazë për përfundimin e kohezionit social që janë themelet e integritimit evropian, pasi kohezioni nënkupton reduktimin e dallimeve ndërmjet vendeve anëtare aktuale të BE-së e atyre që do të bëhen në të ardhmen, dhe si rezultat në fund, do të kemi konvergencën e zhvillimit ekonomik e social, pakësimin e mospërputhjeve rajonale e rritjen e punësimit e konkurrencës.

Gjithashtu, CBC ka iniciuar një proces madhor të edukimit të pjesëmarrësve në ato programe. Ata po njihen me mënyrën e të menduarit rreth projekteve e qëllimeve të reja që do të realizohen dhe mënyrën se si këto projekte kontribuojnë jo vetëm në bashkëpunimin e tyre, por edhe për të pasur një jetë më të mirë për qytetarët e për të kapërcyer problemet e vështira në marrëdhëniet ndëretnike të trashëguara nga e kaluara. Ata gjithashtu kanë mësuar mënyrën se si zbatohen projektet, se si bëhet raportimi financiar dhe kontrolli i punës së kryer, se si të respektohen afatat e caktuara e të punohet shumë për përbushjen e tyre, e së fundmi, të ndiejnë kënaqësi kur projekti jep rezultate.

Kjo punë është pak të themi e vështirë, por Ministria e Financave, nëpërmjet Sektorit të Programimit dhe Menaxhimit të Fondeve të BE-së e Zhvillimit të Asistencës, ka arritur me sukses të krijojë një mënyrë të re komunikimi me përfituesit potencialë në zonat ku po zbatohen këto programe. Ne krijuam një rrjet të zyrave lokale në Subotica, Vrsac, Bor, Nis, Sremska Mitrovica, Uzice dhe Prijepolje nëpërmjet të cilave cilido që është i interesuar mund të marrë të gjithë informacionin e të shprehë nevojat për trajnim që do tu sigurohen gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të programit. Ngritja e një sistemi të fuqishëm të IT ishte gjithashtu një ndihmë e madhe. Sistemi mundëson raportime të drejtpërdrejta në internet; organizon të gjithë dokumentet dhe jep akses me lehtësi për t'i gjetur ato, si dhe jep përgjigje ndaj pyetjeve më të shpeshta në internet. Sigurisht që ka një entuziazëm të madh e punë ndërmjet të gjithë pjesëtarëve të ekipit për të siguruar komunikim të përhershëm e në kohën e duhur me pjesëmarrësit potencialë në program dhe me ata projektet e të cilëve janë miratuar.

Qëllimi ynë është që të kapërcëjmë stereotipet se nuk ka mjaftueshëm projekte, se nuk ka kapacitete për zbatimin e tyre dhe se paratë nuk janë shpenzuar për objektivat e përcaktuara. Unë besoj se ne ia kemi dalë mbanë të kapërcëjmë sa më sipër kryesisht nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta e vendosjes së standardit 'tolerancë zero' për rastet negative – ato duhen shmangur, dhe nëse ndodhin, duhet të korrigjohen menjëherë me pasojat përfundimtare të mbylljes së projektit dhe kërkesën për kthimin e të gjitha parave të shpenzuara deri në atë moment. Ky mesazh iu komunikua qartë të gjithë pjesëmarrësve në projekt nga dita e parë dhe nuk ka pasur kthim mbrapa. Serbia ka qenë mjaftueshëm me fat, kështu që puna e madhe për të kapërcyer rregullat e komplikuar financiare të parashtuara nga BE-ja ia ka vlejtur se ka dhënë frytet e veta. Nuk është anuluar asnjë projekt dhe fondet nga projektet e mëparshme ndërkuftare janë përdorur plotësisht. Afërsisht 200 projekte, që tashmë janë në faza të ndryshme zbatimi, janë krijuar përgjatë kufijve me Hungarinë, Rumaninë dhe Bullgarinë.

CBIB: Programet me vendet fqinje në Ballkanin Perëndimor – një sfidë këto?

G.L.: Ajo që u mësua gjatë zbatimit të Programeve të Fqinjësisë do të zbatohet në praktikë në bashkëpunimin ndërkuftar me vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky bashkëpunim do të jetë shumë më i lehtë pasi nuk ka viza dhe barrierat gjuhësore. Lidhjet ekonomike janë gjithashtu shumë të forta. Ato që shoh si probleme të mundshme janë zhvillimi relativisht i ndryshëm i disa zonave kufitare, konfigurimi i pafavorshëm i terrenit dhe mosekzistenca e qendrave të forta ekonomike dhe universitare që mund të përdorin njohuritë dhe përvojën e tyre dhe forcën e tyre relativisht të qëndrueshme

financiare për të mbështetur bashkë-financimin e programeve në thirrjen e parë për propozime. Gjithashtu, densiteti relativisht i ulët i popullsisë është shqetësues pasi e gjithë puna kryhet nga vetë njerëzit. Gjithsesi, unë shpresoj se këto probleme do të kapërcehen dhe, në bazë të përvojës së fituar nga Programet e Fqinjësisë, do të gjenden zgjidhje të përshtatshme për t'iu përshtatur karakteristikave të bashkëpunimit me Bosnjën dhe Hercegovinën e Kroacinë.

Serbia, bazuar në përvojën me Programet e Fqinjësisë, do të menaxhojë sekretariatet e përbashkëta teknike për Bosnjën dhe Hercegovinën e Malin e Zi. Kjo është një përgjegjësi e madhe gjithashtu pasi është hera e parë që një vend i cili nuk është anëtar i BE-së po menaxhon një strukturë të tillë administrative. Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që Serbia nuk ka hezitur as edhe një moment për të ndarë përvojën e saj, rregullat e për të zhvilluar softwaere IT për monitorimin e projekteve në bashkëpunimin ndërkuftar.

CBIB: Cili është organizimi i brendshëm dhe cilat janë kapacitetet e Ministrisë për të zbatuar programet?

G.L.: Ministria e Financave në mënyrë të vazhdueshme monitoron zhvillimet e reja në CBC dhe përpiqet të sigurojë mjetet e duhura financiare dhe materialet për të kryer detyrat e veta. Asistenca që erdhi nga programi CARDS ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për të rritur kapacitetet e departamentit për bashkëpunimin ndërkuftar. Ekspertiza e përbashkët dhe vlerat monetare nga BE-ja dhe PNUD ndihmuan në ndërtimin e strukturave të reja administrative, edukimin e punonjësve, ndihmë për të liruar barrën e kostove të larta në ngritjen e institucioneve të reja dhe në lehtësimin e presioneve ndaj buxhetit. Gjithashtu, Qeveria Serbe mbështeti shtrirjen e administratës në fushën e bashkëpunimit ndërkuftar dhe mundësoi rritjen e vazhdueshme të numrit të punonjësve. Gjithsesi, paqëndrueshmëria në radhët e personelit është ende e lartë.

Përsa i përket gadishmërisë për programe me vendet e Ballkanit Perëndimor, ajo është e kënaqshme për momentin. Ne ngritëm sekretariatet e përbashkëta teknike dhe zyrat e reja lokale dhe punësuam e trajnuam individët për të qenë gati për hapjen e thirrjeve për propozime që pritet nga fundi i këtij viti. Gjithashtu, punuam shumë duke u takuar me njerëzit e organizatave në zonat përfutuese të fondeve dhe u prezantuam atyre përbajtjen e programeve dhe veprimtarive që mund të financohen. Kjo punë nuk u bë vetëm nga Ministria, por edhe nga përfaqësuesit e projektit rajonal të Komisionit Evropian, CBIB. Ky projekt ishte i një rëndësie të veçantë për vendet që nuk kishin përvojë, apo kishin përvojë të pakët në punën me projektet e bashkëpunimit ndërkuftar.



Intervistë: Znj. Nada Bojanic, Shefe e Departamentit për Bashkëpunimin Ndërkufitar, Drejtorja për Integrimin Evropian e Bosnjës dhe Hercegovinës



Znj. Nada Bojanic foli rreth sfidave në zbatimin e programeve të CBC në rajon, programeve specifike të zbatuara deri më sot dhe detyrave që shtrohen përpara një ekipi të vogël, por të përkushtuar në Bosnjë dhe Hercegovinë.

CBIB: Bosnja dhe Hercegovina së fundmi nënshkroi MSA-në. Si do të kontribuojë CBC në arritjen e integrimin evropian?

N.B.: Marrëveshja përfshin një kapitull mbi Bashkëpunimin Rajonal, që kërkon forcimin e bashkëpunimit rajonal me vendet e tjera të përfshira nga procesi i Stabilizimit dhe Asociimit. CBC që do të lançohet duke vënë në përdorim fondet e BE-së në bazë të komponentit të dytë të IPA-s ndërmjet vendeve në rajon, do të rrisë përbushjen e këtij qëllimi, por gjithashtu, ashtu si edhe programet e tjera ekzistuese të CBC nëpër të gjithë BE-në, do të kontribuojë në zhvillimin social dhe ekonomik të rajoneve kufitare, do të rrisë partneritetin e komuniteteve lokale në të dyja anët e kufirit për të zgjidhur probleme të përbashkëta e për të çuar në ndërtimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë e në stabilitet.

Gjithashtu, duke pasur parasysh se shumica e fondeve strukturore përsëriten në Rregulloren Zbatuese të IPA-s, pjesëmarrja në programet e IPA CBC përfaqëson përgatitjen për fazat vijuese në rrugën tonë drejt BE-së, përkatësisht për pjesëmarrjen në të ardhmen në tre komponentët e tjerë të IPAs-s dhe, përfundimisht, në fondet strukturore të BE-së, me aderimin tonë në BE.

CBIB: Në cilin program në bazë të IPA CBC mund të marrë pjesë Bosnja dhe Hercegovina dhe çfarë fondesh ka në dispozicion?

Në bazë të IPA CBC, Bosnja dhe Hercegovina marrin pjesë në 6 programe: Programi i CBC IPA Adriatik, tre programe dypalëshe me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor: Kroacinë,

Serbinë dhe Malin e Zi dhe dy programe transnacionale: South-East European Space - Hapësira Evropiane Jug-Lindore (SEES) dhe Mediterranean – Mesdheu (MED).

Alokimi për Programin Adriatik është caktuar nga Komisioni Evropian (€6 milion për tre vjet 2007-2009), ndërsa për programet e tjera kemi shpërndarë fondet që kishim në dispozicion për secilin prej tyre në baza vjetore. Kjo u krye gjatë fazës së programimit në vitin 2007.

Ne jemi përpjekur të sigurojmë alokime të ekuilibruara për të dyja anët e kufirit. Për shembull, për programin me Kroacinë kemi €1 milion për secilin vend, me Malin e Zi, Bosnja dhe Hercegovina ka €0.5 dhe Mali i Zi €0.6 milion dhe me Serbinë €0.7 milion për anën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe €1.1 milion për anën serbe. Për SEES, alokimi vjetor i Bosnjës dhe Hercegovinës është rreth €0,45 milion dhe për MED €0,1 milion.

CBIB: Cila ka qenë përvoja e deritanishme e Bosnjës dhe Hercegovinës në CBC?

N.B.: Nga viti 2004, Bosnja dhe Hercegovina ka marrë pjesë në 17 projekte brenda INTERREG III A Adriatik dhe dy projekte brenda programeve INTERREG IIIB CADSES me kontribute "në natyrë".

Kjo pjesëmarrje e kufizuar në këto dy programe është ndryshuar me alokimet e CARDS Rajonal në mbështetje të pjesëmarrjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor në Programet e Fqinjësisë së Re.

Në periudhën 2004-2006, Bosnja dhe Hercegovina përmbushte kriteret e pranueshmërisë për INTERREG IIIA Adriatik NNP dhe INTERREG IIIB CADSES NNP, ku u fitua përvoja e parë e vërtetë me projekte në kuadrin e CBC. Nga 93 projekte të miratuara në Adriatik NNP, 27 projekte kanë përfshirë partnerë nga vendi ynë dhe vlera totale e projekteve ishte €1.259.000, ndërsa në kuadrin e CADSES NNP, kemi pasur dy projekte me një vlerë totale prej €200.000.

Gjithsesi, programimi për IPA CBC 2007-2013, që u krye gjatë vitit 2007 nëpërmjet Komitetit të Përbashkët të Programimit dhe Ekipeve Hartuese të Programit të ngritura për këtë qëllim, dhe me mbështetjen e CBIB, rezultuan në ngritjen e programeve në kuadrin e CBC që u miratuan nga Komisioni Evropian në dhjetor 2007. Ajo ishte një përvojë e vlefshme dhe një bazë e mirë për zhvillime të mëtejshme.

CBIB: Cilën mund të konsideroni si sfidën më të madhe për zbatimin e suksesshëm të CBC në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në rajon?

N.B.: Sfida jonë tani është menaxhimi i të gjithë gjashtë programeve me përvojën tonë të pakët në CBC, në veçanti me tre programet dypalëshe që po lançohen për herë të parë.

Në bashkëpunim me Strukturat Operative (OS) të vendeve partnere, tashmë po ngremë strukturat e përbashkëta për zbatimin e secilit prej këtyre Programeve. Emërimet e Komitetit të Përbashkët të Monitorimit (JMC) janë përfunduar dhe po planifikojmë takimet e para gjatë tetorit 2008 për të cilat janë duke u përgatitur një sërë dokumentesh (Rregulloret e Procedurave të JMC, Manuali i JTS, Thirrja për Propozime me Manualin për Aplikantët), e që do të vihen në axhendë për aprovim.

Përsa i përket Sekretariateve të Përbashkëta Teknike (JTS), kohët e fundit kemi botuar njoftimin për vende pune për tetë pozicione në JTS/Antena për anën e Bosnjës dhe Hercegovinës. Shpresohet që nga tetori 2008, stafi i JTS dhe Antenës do të jenë rekrutuar përfundimisht. Sfida e parë e JTS dhe Antenës është që të bëhen plotësisht operative në vijim dhe, në lidhje me këtë, projektet e asistencës teknike të Komisionit Evropian do të luajnë një rol të rëndësishëm.

Komisioni Evropian ka bërë të disponueshme shumë prej €520.000 nga CARDS Rajonal, fondet për 2005/06 për Bosnjën dhe Hercegovinën, për të mbuluar kostot fillestare për ngritjen e strukturave të përbashkëta. Kontrata për grantin e drejtpërdrejtë për DEI-n me vlerë €400 000 është nënshkruar tashmë, ndërsa pjesa tjetër prej €120 000, do të mbetet në ECD dhe do të përdoret për prokurimin e aparatave dhe pajisjeve për JTS dhe Antenën, si dhe për pagesat e vlerësuesve të projekteve që do të dorëzohen pas lançimit të Thirrjes së Propozimeve. Granti i drejtpërdrejtë do të mbulojë kostot korrente të JTS dhe Antenës për 18 muajt e parë.

Duke qenë se tashmë kemi organizuar shumë seminare ndërgjegjësuese në vende të ndryshme nëpër të gjithë Bosnjën dhe Hercegovinën, në bashkëpunim me CBIB dhe aktorë të ndryshëm lokalë me synimin për të shpërndarë informacion rreth IPA CBC, tani ndodhemi përpara sfidës së përbushjes së pritshmërisë së krijuar në këta aktorë që janë pjesë e procesit.

Së fundmi, duke qenë se përfituesve të ardhshëm do tu kërkohet sigurimi i një minimumi prej 15% bashkë-financim, kapaciteti i tyre financiar përfaqëson një parakusht të rëndësishëm për suksesin e programeve në kuadrin e IPA CBC.





Zona e programimit

Serbia	15,370 km ²
Bosnja dhe Hercegovina	17,612,01 km ²
Totali i zonës përfituese	32,982,01 km ²
Popullsia totale	2,976,023
Gjatësia e kufirit	382,8 km
Kalimet kufitare	8

Serbi – Bosnjë dhe Hercegovinë

ZONAT PËRFITUESE:

Në Serbi janë rajonet e Sremski, Macvanski, Kolubarski dhe Zlatiborski.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë janë bashkitë nga tre rajone ekonomike: Veri-Perëndim, Veri-Lindje dhe Jug-Lindje.

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM STRATEGJIK:

Të mbledhë së bashku njerëzit, komunitetet dhe ekonomitë e zonës kufitare për të marrë pjesë bashkarisht në zhvillimin e një zone bashkëpunuese, duke përdorur burimet e saj njerëzore, natyrore dhe ekonomike, si dhe avantazhet.

Vendndodhja e Sekretariatit të Përbashkët Teknik: Uzice, Serbi.

Vendndodhja e antenës: Tuzla, Bosnjë dhe Hercegovinë.

Prioriteti 1	Kohezion socio-ekonomik nepermjet aksioneve te perbashketa per te permiresuar infrastrukturen dhe kapacitetet fizike, te biznesit, ato sociale dhe institucionale
	Permiresim i produktivitetit dhe konkurruesmerise se burimeve ekonomike, rurale dhe ambientale te zones
Masa I.2	Iniciativa nder-kufitare te cilat synojne shkembimin e njezve dhe ideve per te permiresuar bashkepunimin profesional dhe te shoqerise civile

Prioriteti 2	Asistenca teknike
---------------------	-------------------



Zona e programimit

Serbia	10,063 km ²
Mali i Zi	9,369 km ²
Totali i zones perfituese	19,432 km ²
Popullsia totale	847,787
Gjatesia e kufirit	250 km
Kalimet kufitare	2 (6)

Serbi – Mali i Zi

ZONAT PERFITUESE:

Ne Serbi zona perfituese perfshin komunat e Zlatiborski dhe Raski.

Ne Malin e Zi ato mbulojne bashkite e Pljevlja, Bijelo Polje, Berane, Rozaje, Plav, Andrijevica, Kolasin, Mojkovac, Zabljak, Pluzine, Savnik. Bashkite e Cetinje, Podgorica dhe Danilovgrad jane ne zonen perfituese shtese.

OBJEKTIVI I PERGJITHSHEM STRATEGJIK:

Te bashkoje njerëzit, komunitetet dhe ekonomitë e zonës kufitare me qellim pjesemarrjen e perbashket ne zhvillimin e zones se bashkepunimit, duke perdorur burimet dhe avantazhet e saj njerëzore, natyrore dhe ekonomike.

Vendodhja e Sekretariatit te Perbashket Teknik: Prijepolje, Serbi.

Vendodhja e antenes: Bijelo Polje, Mali i Zi.

Prioriteti 1	Kohezion socio-ekonomik nepermjet aksioneve te perbashketa per te permiresuar infrastrukturen dhe kapacitetet fizike, te biznesit, ato sociale dhe institucionale
	Permiresim i produktivitetit dhe konkurruesmerise se burimeve ekonomike, rurale dhe ambientale te zones
Masa I.2	Iniciativa nder-kufitare te cilat synojne shkembimin e njezve dhe ideve per te permiresuar bashkepunimin profesional dhe te shoqerise civile

Prioriteti 2	Asistenca teknike
---------------------	-------------------



Zona e programimit

Kroacia	6,609 km ²
Serbia	11,703 km ²
Totali i zones perfituese	18,312km ²
Popullsia totale	1,888,905
Gjatesia e kufirit	318 km
Kalimet kufitare	8

Kroacia – Serbia

ZONAT PERFITUESE:

Ne Kroaci perfshijne komunat e Osjecko-Baranjska dhe Vukovarsko-Srijemska

Ne Serbi do te perfitojne 4 bashki: North-Backa, West-Backa, South-Backa dhe Srem.

OBJEKTIVI I PERGJITHSHEM STRATEGJIK:

Te stimuloje bashkepunimin nder-kufitar me qellim diversifikimin dhe permiresimin e ekonomise rajonale ne nje menyre te qendreshme nga pikepamja sociale dhe ambientale, ndersa ne te njejten kohe te permiresoje marrdheniet e fqinjesis se mire ndermjet kufijve.

Vendodhja e Sekretariatit te Perbashket Teknik: Zagreb, Kroaci.

Vendodhja e antenes: Sremska Mitrovica, Serbi.

Prioriteti 1	Zhvillim i qendrushem socio-ekonomik
Masa I.1	Zhvillimi ekonomik
Masa I.2	Ruajtja e ambientit
Masa I.3	Person me person

Prioriteti 2	Asistenca teknike
---------------------	-------------------



Prioriteti 1	Te mbeshtese krijimin e nje ambienti te perbashket soci-ekonomik per njezëzit, komunitetet dhe ekonomite e zonave perfituese
Masa I.1	Iniciativa te zhvillimit ekonomik nder-kufitar me theks ne zhvillimin e turizmit dhe zonave rurale
Masa I.2	Iniciativa te zhvillimit ambiental kryesisht per ruajtjen, promovimin dhe manaxhimin e burimeve natyrore
Masa I.3	Kohezioni social dhe shkembimet kulturore nepermjet nderhyrjeve institucionale dhe atyre person-me-person

Prioriteti 2	Asistenca teknike per rritjen e kapaciteteve administrative per manaxhimin dhe implementimin e programit CBC
---------------------	---

Bosnje dhe Hercegovina – Mali i Zi

ZONAT PERFITUESE:

Ne Bosnje dhe Hercegovine perfsihjne te gjitha bashkite e rajoneve ekonomike te Sarajeves dhe Hercegovines.

Ne Malin e Zi ato mbulojne bashkite e Pljevlja, Pluzine, Zabljak, Savnik, Niksic, Herceg Novi, Kotor, Tivat, Bijelo Polje, Mojkovac, Berane, Kolasin.

OBJEKTIVI I PERGJITHSHEM STRATEGJIK:

Te nxishe nje zhvillim te qendrueshem te zones nder-kufitare, burimet dhe potencialet e saj ekonomike, kulturore, natyrore dhe njerezore nepermjet forcimit te kapaciteteve te burimeve njerezore dhe njeteve te perbashke institucionale ndermjet komuniteteve lokale si dhe paleve te interesuara private dhe publike.

Vendodhja e Sekretariatit te Perbashket

Teknik: Sarajeva, Bosnje dhe Hercegovina.

Локација на антената: Niksic, Mali i Zi.



Zona e programimit

Bosnje dhe Hercegovina	20,459.90 km ²
Mali i Zi	8,784 km ²
Totali i zones perfituese	29,243.90 km²
Popullsia totale	1,355,278
Gjatesia e kufirit	249 km
Kalimet kufitare	7

Prioriteti 1	Krijimi i nje hapsire te perbashket ekonomike
Masa I.1	Zhvillimi i perbashket i ofertes turistike
Masa I.2	Promovimi ndermarrjes se iniciativave te biznesit

Prioriteti 2	Cilesi me e mire e jeteses dhe kohezion social
Masa I.1	Ruajtje e natyres dhe ambientit
Masa I.2	Akses i permiresuar i serviseve me baze komunitare ne zonen kufitare

Prioriteti 3	Asistenca teknike
---------------------	--------------------------

Kroacia – Bosnje dhe Hercegovina

ZONAT PERFITUESE:

Ne Kroaci perfsihjne komunat e Vukovarsko-Srijemska, Brodsko Posavska, Sisacko-Mostavska, Karlovacka, Licko-Senjska, Zdrska, Sibensko-Kninska, Splitsko-Dalmatinska, Dubrovacko-Neretvanska dhe zonat perfituese shtese jane Osjecko-Baranjska, Bjelovarsko-Bilogorska, Pozesko-Slavonska, Zagrebada dhe Promorsko-Goranska. Ne Bosnje dhe Hercegovine ato mbulojne tre rajone ekonomike Veri-Perendim, Veri-Lindje dhe Hercegovina.

OBJEKTIVI I PERGJITHSHEM STRATEGJIK:

Inkurajimi i krijimit te njeteve dhe partneriteteve nder-kufitare dhe zhvillimi i aksioneve te perbashketa nder-kufitare me qellim rigjallërimin e ekonomise, ruajtjen e natyres dhe ambientit dhe permiresimit te kohezionit social te zones se programimit.

Vendodhja e Sekretariatit te Perbashket

Teknik: Зарпб, Хрватска.

Vendodhja e antenes: Banja Luka dhe Mostar, Bosnje dhe Hercegovina



Zona e programimit

Kroacia	30,882 km ²
Bosnja dhe Hercegovina	38,022 km ²
Totali i zones perfituese	68,904 km²
Popullsia totale	4,394,831
Gjatesia e kufirit	992 km
Kalimet kufitare	

Dokumenti Indikativ i Planifikimit Shumë-vjetor 2007 – 2009 për Bosnjën dhe Hercegovinën: Indikacione financiare – IPA Komponenti II

Programi CBC	Fondet IPA 2007	Fondet IPA 2008	Fondet IPA 2009
IPA Adriatik CBC	1.313	2.243	2.446
Bosnja dhe Hercegovina – vend kandidat fqinj/potencial kandidat dhe programet ERDF ndërrajonale dhe transnacionale	2.653	2.706	2.760
Total	3.966	4.949	5.206

Dokumenti Indikativ i Planifikimit Shumë-vjetor 2007 – 2009 për Serbinë: Indikacione financiare – IPA Komponenti II

Programi CBC	Fondet IPA 2007	Fondet IPA 2008	Fondet IPA 2009
Serbia – Hungaria	1.334	2.279	2.486
Serbia – Rumania	1.580	2.698	2.943
Serbia – Bullgari	1.265	2.160	2.356
IPA Adriatik CBC	0.319	0.546	0.595
Serbia – vende kandidat potenciale dhe programet ERDF ndërrajonale dhe transnacionale	3.714	3.789	3.864
Total	8.212	11.472	12.244

Delegacioni i Komisionit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë



DELEGATION OF THE EUROPEAN COMMISSION
TO BOSNIA AND HERZEGOVINA

Delegacioni i Komisionit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë (ECD) u ngrit në 10 korrik 1996 dhe që atëherë ka luajtur një rol të rëndësishëm në drejtimin e Politikës së Përbashkët të Jashtme e të Sigurisë duke nxjerrë raporte të rregullta politike, duke kryer vlerësime në bashkëpunim me Ambasadat e Vendeve Anëtare e duke kontribuar në procesin e politikë-bërjes.

ECD luan një rol kyç në zbatimin e asistencës së jashtme, mjaft të konsiderueshme për Bosnjën dhe Hercegovinën. Asistenca aktuale e Komisionit Evropian për Bosnjën dhe Hercegovinën (BiH) është "dekoncentruar" dhe kështu, përgjegjësia e menaxhimit i mbetet ECD. Ndërsa decentralizimi në të ardhmen i asistencës së Komisionit Evropian për vendin është edhe synim i këtij të fundit, mbeten ende reforma të konsiderueshme institucionale si parakusht përpara ndërmarrjes së një hapi të tillë.

Që nga viti 1991, asistenca e Komisionit Evropian për Bosnjën dhe Hercegovinën shkoi në më shumë se € 2.5 bilion. Ndërmjet periudhës 2001 dhe 2006, burimi kryesor i asistencës së BE-së për vendin ishte programi CARDS, që siguroi €4.6 bilion për mbështetje në forcimin institucional në vend. Në vitin 2007, Instrumenti për Asistencën Para-Aderimit (IPA) zëvendësoi instrumentet e mëparshëm të para-aderimit. Kohët e fundit Bosnja dhe Hercegovina, si vend potencial kandidat, është i pranueshëm për dy komponentë të IPA-s: Asistenca për Tranzicionin dhe Asistenca për Forcimin Institucional dhe Bashkëpunimin Ndërkufitar.

Objekti i Asistencës për Bashkëpunimin Ndërkufitar në Bosnjë dhe Hercegovinë është mbështetja e institucioneve të rëndësishme shtetërore dhe lokale, si dhe e organizatave për të marrë pjesë me sukses në projekte që kanë lidhje me programet e BE-së që nxisin bashkëpunimin ndërkufitar, transnacional dhe ndër-rajon.

Buxheti tre-vjetor për të gjashtë programet e IPA CBC ku merr pjesë Bosnja dhe Hercegovina për periudhën 2007 – 2009 është gati €9 milion.

Përsa i përket zbatimit të IPA-s, Delegacioni i Komisionit Evropian kryen rolin e Autoritetit Kontraktues. Ku flitet për programet e bashkëpunimit ndërkufitar, nënkuptohet se Delegacioni ka detyrën të mbyllë kontratat me aplikantët e Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilët kanë fituar grante, si dhe zbatimin e tyre në vijim në terma financiar.

Të gjitha veprimtaritë që kanë lidhje me monitorimin të drejtuara nga Drejtoria për Integrimin Evropian dhe strukturat e përbashkëta të menaxhimit (Komitetet e Përbashkëta të Monitorimit dhe Sekretariatet e Përbashkëta Teknikë/Antenat) koordinohen me Task Menaxherin e ECD për bashkëpunimin ndërkufitar në Seksionin e Zhvillimit Ekonomik të ECD-së.

Projekti EU CORIN: Në Mbështetje të Bashkëpunimit Ndërkufitar



Projekti EU CORIN, financuar nga BE-ja dhe zbatuar nga një konsorcium ndërkombëtar kompanish, drejtuar nga Hypodomi Consulting S.A. (Greqi), është bërë operativ që nga 16 korriku 2007.

Projekti është ngritur për të ndihmuar fillimin e krijimit si të strukturave shtetërore, edhe atyre të përbashkëta të menaxhimit për zbatimin e programeve të CBC me vendet fqinje të Bosnjës dhe Hercegovinës. Projekti synon edhe të ketë rolin e tij lehtësues në përgatitjen dhe lançimin e Thirrjeve për Propozime dhe në rritjen e kapaciteteve të aplikantëve potencialë për të përfituar sa më shumë nga mundësitë për grante.

Ekipi i EU CORIN jep këshillim dhe mbështetje për Drejtorinë e Integritimit Evropian (DEI), si përfituesi kryesor i këtij projekti, në rolin që luan si Koordinator dhe Struktura Operative në kuadrin e IPA Komponenti II për programet ndërkufitare, dhe si Koordinator Kombëtar i IPA-s (NIPAC), si përfaqësues i Bosnjës dhe Hercegovinës. Projekti

siguron edhe trajnim dhe mbështetje për të gjitha strukturat e menaxhimit që kanë lidhje me CBC e që ndodhen në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Arritjet e deritanishme të EU CORIN ...

Fokusi i rëndësishëm i projektit EU CORIN ka qenë dhënia e mbështetjes për DEI-n për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë në bazë të Rregullores Zbatuese të IPA-s. Për shembull, kjo ka përfshirë hartimin e një aplikimi për grantin e drejtpërdrejtë për të mundësuar ngritjen e Sekretariatit të Përbashkët Teknik/Antenës, si dhe dhënien e asistencës në rekrutimin e stafit për këto struktura.

Projekti ka mbështetur edhe hartimin e Termave të Referencës për krijimin e një Pike Kontakti për Programin e Evropës Jug-Lindore, që u finalizua dhe iu parashtrua Sekretariatit të Përbashkët Teknik në maj 2008.

EU CORIN gjithashtu ka dhënë asistencë për zhvillimin e "Strategjisë për Zbatimin e Sistemit të Decentralizuar të Zbatimit për Menaxhimin e Asistencës së Komisionit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë" për komponentët I dhe II, që u aprovua në qershor 2008.

Me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së Bosnjës dhe Hercegovinës në IPA Adriatik CBC, EU CORIN hartoi një draft të parë të Termave të Referencës për një kontratë kuadër. Me miratimin e tij, do të vijohet me hartimin e projekteve shumëpalëshe

paralel me organizimin e evenimeve të para të kërkimit të partnerëve përpara lançimit të Thirrjes së 1-rë për Propozime.

Veprimtaritë në vijim të EU CORIN ...

Në periudhën në vijim, ekipi i EU CORIN do të japë konsultime për Strukturat Menaxhuese të Programit të IPA CBC në përgatitjen e dokumenteve të skemës së grantit, Thirrjeve për Propozime dhe paketave të thirrjes, duke përfshirë udhëzuesit për aplikantët, draft kontratat, etj. Në po këtë periudhë do të kemi edhe një sërë trajnimesh në lidhje me zbatimin e programeve të IPA CBC me fokus të veçantë në Skemat e Granteve të IPA CBC për grupet e ndryshme të synuara.

Me qëllim që të kuptohen më tej aspektet praktike të zbatimit të Programit të CBC e të thellohen partneritetet midis përfaqësuesve të strukturave pjesëmarrëse të IPA CBC, EU CORIN do të organizojë një tur ndërkombëtar studimor për Strukturat e IPA-s në Bosnjë dhe Hercegovinë që do të mbahet në katër-mujorin e fundit të vitit 2008.

Së fundmi, EU CORIN do të intensifikojë veprimtaritë me synim rritjen e ndërgjegjësimit për bashkëpunimin ndërkufitar, si dhe për programet e IPA CBC e mundësitë e financimit brenda kuadrit të skemave të financimit me grante të BE-së.





Agjensia Rajonale e Zhvillimit (RDA) NERDA mbulon fushën e rajonit ekonomik verilindor të Bosnjës dhe Hercegovinës me 34 bashki dhe Rajonin Brcko me veprimtaritë e tij. Pas ndërtimit të infrastrukturës së brendshme dhe një rrjeti prej pesë zyresh (zyra kryesore është në Tuzla dhe katër zyra nën-rajonale janë në Bijeljina, Orasje, Brcko dhe Zvornik) NERDA, me ekipin e saj prej 16 ekspertësh, e ka justifikuar plotësisht emërtimin e një agjensie rajonale.

NERDA u themelua në 2004 dhe filloi punën në janar 2005. Që nga fillimi fare u mbështet nga Delegacioni i Komisionit Evropian në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe kapacitetet e saj u fuqizuan në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet projekteve të Bashkimit Evropian për të mbështetur zhvillimin lokal e ekonomik. Një nga mënyrat më të mira për të treguar suksesin e NERDA-s dhe kredibilitetin e saj është projekti CREDO (projekt për zhvillimin konkurrues rajonal ekonomik në Bosnjë dhe Hercegovinë), realizimi i të cilit u besua tërësisht NERDA-s. Kjo ishte hera e parë që një projekt i një volumi e vlere të tillë (€3.2 milion) u zbatua në mënyrë të pavarur nga një organizatë e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Në mars 2007, përfaqësuesit e NERDA-s morën pjesë në seminarin teknik të CBIB në Zagreb me qëllim që të njiheshin më mirë me procedurat e zbatimit të fondeve të IPA-s për bashkëpunimin ndërkufitar, pas të cilit ata filluan një fushatë informimi dhe promovimi për këtë program, duke bërë lobim nëpër bashki për të marrë pjesë aktive në përgatitjen e dokumenteve të programit. Nëpërmjet bashkëpunimit me Drejtorinë për Integrimin Evropian të Bosnjës dhe Hercegovinës (DEI) dhe me projektin e CBIB, NERDA mblodhi të dhëna për indikatorët social dhe ekonomik të bashkive për nevojat e një analize SWOT.

Në bashkëpunim me DEI-n dhe CBIB, NERDA ndihmoi në prezantimin e programeve dhe procedurave për bashkëpunimin ndërkufitar në Rajonin e Brckos dhe Tuzlës në dhjetor 2007 dhe mars 2008 përkatësisht.

DEI (Koordinatori Kombëtar i IPA-s) ka vlerësuar RDA-të si partnerë të mirë e me kapacitet për të asistuar në zbatimin e programeve të CBC në këtë fushë. NERDA, së bashku me tre RDA të tjera në Bosnjë dhe Hercegovinë, formoi një partneritet me DEI-n dhe do të përfaqësojë një pjesë të strukturave operative në programin midis Bosnjës dhe Hercegovinës e Serbisë. Antena, zyra për zbatimin e programit në Bosnjë dhe Hercegovinë, do të vendoset në Tuzla në ambientet e NERDA-s. Në këtë mënyrë NERDA do të ofrojë infrastrukturën e saj, burimet, njohuritë dhe rrjetin e kontakteve në rajon për Antenën.



Bashkëpunimi ndërkufitar, si një nga pesë komponentët e IPA-s, luan një rol të rëndësishëm në mundësinë për të financuar projekte e iniciativa të caktuara me interes të përbashkët për partnerët ndërkufitar. Për herë të parë Bosnja dhe Hercegovina mund të marrë pjesë në programe të bashkëpunimit ndërkufitar të financuara të BE drejtpërdrejt, dhe po në të njëjtin nivel si vendet e tjera.

Rajoni i Hercegovinës, me pozicionin e saj gjeografik, përmbush kriterin e pranueshmërisë për të marrë pjesë në tre programe ndërkufitare: Kroaci – Bosnjë & Hercegovinë – Bosnjë & Hercegovinë – Mali i Zi dhe Programi Adriatik. Përveç impaktit të drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik e social, këto programe janë gjithashtu jashtëzakonisht të rëndësishme nga perspektiva e përgatitjes së autoriteteve lokale e rajonale për të përdorur fonde nga komponentët e tjerë të IPA-s, por edhe për të përdorur para nga fonde të tjera të BE-së dhe fondet strukturore në të ardhmen.

Duke pasur parasysh se mjetet që janë në dispozicion nga programet ndërkufitare nuk janë të mëdha, shpresat më të mëdha janë drejtuar tek fitimi i përvojës e gjetja e partnerëve nga zonat ndërkufitare, së bashku me projekte konkrete për të zgjidhur sfida të përbashkëta specifike.

Agjensia Rajonale e Zhvillimit për Hercegovinë, REDAH, e ka vlerësuar bashkëpunimin ndërkufitar si një nga mënyrat për të përdorur fondet nga BE për të iniciuar ide për projekte të përbashkëta e për të zhvilluar projekte që do të zgjidhin probleme të përbashkëta. Programet dypalëshe me Kroacinë dhe Malin e Zi janë të një rëndësie të veçantë për Hercegovinë pasi janë të lidhura në mënyrë funksionale dhe natyrore me zonat kufitare të Dalmacisë dhe Malit të Zi, dhe ka një numër prioritetesh të përbashkëta të zhvillimit, si për shembull, zhvillimi i turizmit, mbrojtja e mjedisit, bashkëpunimi ekonomik, zhvillimi i produkteve të përbashkëta, etj.

Me qëllim që të përdoren fondet që janë në dispozicion në mënyrën e duhur, REDAH, si një RDA e themeluar nga 23 bashki në Hercegovinë, së bashku me partnerë nga sektori i biznesit dhe joqeveritar, ka ndërmarrë një sërë hapash për të qenë e përgatitur për këto programe. Ato përfshijnë takime me aktorët lokalë e rajonalë, mbledhje informacioni, krijimin e lidhjeve me partnerë ndërkufitarë, iniciimin dhe zhvillimin e ideve për projekte, trajnime për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve e veprimtarive të tjera të domosdoshme për përgatitjen me sukses të këtyre programeve. Gjithashtu, REDAH, bashkë me RDA të tjera në Bosnjë dhe Hercegovinë, ka formuar një partneritet të mirë me Drejtorinë për Integrimin Evropian të Bosnjës dhe Hercegovinës, që është edhe koordinatori kombëtar i këtyre programeve.



Agjensia rajonale e zhvillimit, ADRA NW, në katër vjet pune në rajonin veriperëndimor ekonomik të Bosnjës dhe Hercegovinës ka njohur nevojën për edukim të subjekteve ekonomike si një nga veprimtaritë primare në këtë zonë.

Në kuadrin e përgatitjes së vendeve të Ballkanit Perëndimor për përdorimin e fondeve evropiane (IPA komponenti II, Bashkëpunimi Ndërkufitar), në bashkëpunim me projektin rajonal CBIB, ne morëm pjesë në organizimin e info days (ditëve të informacioni), në prezantime e trajnime. Më shumë se 200 vetë nga rajoni veriperëndimor i Bosnjës dhe Hercegovinës morën pjesë në trajnime në lidhje me përgatitjen e projekteve në bazë të kërkesave të Komisionit Evropian.



Trajnime mbi përgatitjen e projekteve, organizuar nga CBIB dhe ARDA, 22-23 shtator, 2008, Banja Luka

Nëpërmjet prezantimeve, info days – ditëve të informacionit, dhe kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet Agjensisë dhe subjekteve të ndryshme nga rajoni, mbi 500 vetë u njohën me programin. Falë përpjekjeve të Agjensisë, jemi krenarë të themi se nga mbi 1000 projekt propozime në kuadrin e programeve të SEE që u paraqitën në Budapest, një numër i konsiderueshëm u dërgua nga Bosnja dhe Hercegovina e rajoni ynë.

Gjithashtu, ramë dakord që të mbahen dy konferenca në kuadrin e programit të CBC Kroaci – Bosnjë dhe Hercegovinë, përpara hapjes së Thirrjes së parë për Propozime.

Në planin e biznesit për periudhën në vazhdim (2009 – 2011), ARDA synon të vërë burime të konsiderueshme për të mbështetur forcimin e kapaciteteve për të thithur projekte nga ana e përfituesve të ardhshëm të IPA-s nga Bosnjë dhe Hercegovina verilindore.

Për të mbështetur këtë, Antena për programin me Kroacinë është e vendosur në zyrat tona, e cila do të kontribuojë për një bashkëpunim edhe më të ngushtë midis RDA-së dhe strukturës operative të programit.

Përfituesit nga shërbimet tona dhe punonjësit e Agjensisë sonë, janë të kënaqur me veprimtaritë e zbatuara mjaft mirë e me detyrat e ngarkuara në bashkëpunim me CBIB, i cili është një model i mirë për promovimin dhe mbështetjen e linjave të programit nga ky komponent dhe të gjithë të tjerët të parashikuar nga IPA.



Përvoja e Vojvodinës në Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar të BE-së



Ivan Knezevic, Shefi i Sektorit për Menaxhimin e Projekteve, Qendra për Studime Strategjike Ekonomike

Midis viteve 2004 dhe 2006, Provinca Autonome (AP) Vojvodina, mori pjesë në programet e bashkëpunimit ndërkufitar të BE-së me Hungarinë e Rumaninë. Pjesëmarrja e organizatave nga Provinca Autonome e Vojvodinës u bë e mundur me asistencën financiare nga programi CARDS me një vlerë totale prej €9.6 milion. Përvoja e organizatave që morën pjesë në realizimin e projekteve ndërkufitare ka treguar se këto programe kanë një rëndësi të madhe për Provincën Autonome të Vojvodinës. Efekti financiar që haset nëpërmjet përdorimit të granteve të sa më sipër gjithashtu është i rëndësishëm në perspektivën afatshkurtër.

Nga ana tjetër, në perspektivën afatgjatë, këto programe përfaqësojnë mundësinë për të vendosur një bashkëpunim të drejtpërdrejtë me rajonet kufitare nga vendet anëtare të BE-së me synimin për të përmbushur prioritetet të përbashkëta zhvillimi, por edhe për të patur mundësinë e transferimit të njohurive që do të rezultojnë në një përdorim më efikas të

mjeteve nga fondet strukturore me anëtarësimin e Serbisë në BE. Së fundmi, një efekt shumë i rëndësishëm afatgjatë është forcimi i zhvillimit të partneriteteve dhe bashkëpunimit midis aktorëve vendas rajonalë e lokalë.

Fakti se Provinca Autonome e Vojvodinës ndodhet në kufi me rajone nga vendet anëtare të BE-së, të cilët kanë më shumë kapacitete e janë më mirë të njohur me këto programe, ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në organizatat nga Vojvodina që ato të jenë të suksesshme në përgatitjen e zbatimit e projekteve. Në dy thirrje për propozime deri tani, 72 projekte me shumën prej €6.7 milion u miratuan në kuadrin e programeve me Hungarinë e Rumaninë. Nga numri total i projekteve të miratuara, në territorin e Provincës Autonome të Vojvodinës, rreth 60 prej tyre u zbatuan me një vlerë totale prej €5.4 milion. Analiza e thirrjes për propozime tregon se numri më i madh i projekteve të miratuara kishin të bënin me ndërtimin e bashkëpunimit institucional, dhe shpërndarja gjeografike e organizatave që morën asistencë financiare ishte mjaft e balancuar, me një përqendrim të lehtë në katër qendra urbane: Subotica, Novi Sad, Sombor dhe Vrsac.

Gjatë përzgjedhjes së projekteve, fakti se një projekt ndërkufitar duhet të jetë rezultat i iniciativave të përbashkëta lokale dhe rajonale me një efekt të qartë ndërkufitar ishte pika që u vlerësua më shumë, bashkë me aftësitë menaxhuese e financiare e qëndrueshmërinë ekonomike të rezultateve të projektit. Gjithsesi, vlerësimi i projekteve të miratuara tregon se shumica e projekteve ndikon mjaft qartë rajonet e përfshira kufitare, por se projektet e përbashkëta përfaqësojnë më shumë një përjashtim, sesa një rregull. Përvoja tregon edhe

se gjatë realizimit të projekteve të përbashkëta është e një rëndësie madhore që veprimtaritë me partnerët të sinkronizohen me qëllim që të arrihen rezultatet e duhura, ashtu si edhe impakti i projektit e qëndrueshmëria e këtyre rezultateve. Kështu, ndërtimi i mëtejshëm i partneriteteve në projektet e bashkëpunimit ndërkufitar, që do të vijohet nëpërmjet IPA-s në periudhën midis 2007 dhe 2013, është një prioritet për të gjithë pjesëmarrësit në program. Kjo do të jetë edhe më e rëndësishme duke pasur në mendje fondet relativisht të mëdha që do të jenë në dispozicion në kuadrin e programeve të reja (të vjetra) ndërkufitare në shumën prej €16.3 milion për periudhën midis viteve 2007 dhe 2009.

Këshilli Ekzekutiv i Vojvodinës ka një rol të rëndësishëm në përgatitjen e organizatave nga Vojvodina për të marrë pjesë në CBC. Me hapjen e programeve në vitin 2004, Këshilli Ekzekutiv ngriti një sërë institucionesh që i fokusuan veprimtaritë e tyre në rritjen e kapaciteteve të aktorëve lokalë e rajonalë për të marrë pjesë në veprimtaritë ndërkufitare. Në sajë të kësaj iniciative dhe mundësisë për të marrë pjesë në programet e para të bashkëpunimit ndërkufitar, organizatat nga Vojvodina morën njohuritë e kapacitetet e duhura e përmirësuan ndjeshëm aftësitë e tyre për projekte në të ardhmen me programe të reja me Hungarinë, Rumaninë dhe për herë të parë, me Kroacinë.



Partneriteti ndërmjet CBIB dhe projektit 'Rajoni Ekonomik në Ujëndarësen e Savas'

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kuadër për Rajonin Ekonomik në Ujëndarësin e Savas, Dhoma Rajonale e Tregtisë filloi një iniciativë për bashkëpunim midis dhomave të tregtisë në frymën e marrëveshjes, dhe takimi i parë u mbajt në prill 2007 në Sabac u nënshkrua Protokollin për Bashkëpunimin Rajonal midis 12 dhomave të tregtisë nga Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia e Serbia, në prezencën e përfaqësuesve nga ambasadat, dhomat e tregtisë dhe zyrtarëve të tyre. Me mundësinë për të financuar konkretisht mbështetjen e projekteve për periudhën ndërmjet viteve 2007 dhe 2013, janë përmbushur kushtet për të mbledhur të gjitha palët e interesuara e për të ndërtuar kuadrin e duhur për bashkëpunim të të gjitha dhomave të tregtisë në Ujëndarësen e Savas.

Rëndësia ekonomike e Protokollit, që mbulon zonën me 6.8 milion banorë dhe mbi 140,000 kompani, është e jashtëzakonshme dhe, lumi që lidh të gjithë këtë, do të përfaqësojë një bazë për bashkëpunimin ndërkufitar me të gjithë potencialin përkatës.

Projekti, **Rajoni Ekonomik në Ujëndarësin e Savas (ERSUS)**, kufitare në Ballkanin Perëndimor, synon të rrisë bashkëpunimin ekonomik e të unifikojë tregun rajonal në përputhje me Marrëveshjen e CEFTA të vitit 2006. Bashkëpunimi me Komisionin e Savas u krijua në çështjet e transportit, zhvillimin e turizmit, mbrojtjen e mjedisit. Në të njëjtën kohë, CBIB ka dhënë asistencë në kuadrin e njohjes dhe afrimit me fondet e para-aderimit të BE-së. Bashkëpunimi me CBIB hapi një fazë të re të njohjes e shkëmbimeve të përbashkëta të përvojave në procesin e integritimit evropian të rajonit.

Një seminar i titulluar "Fondet e Para-aderimit të BE-së" u organizua për anëtarët e grupit të punës të ERSUS në Sabac, më 23 mars 2008. Në bazë të marrëveshjes së mëparshme, seminari u mbështet nga CBIB dhe Sektori për Bashkëpunimin Ndërkufitar në Ministrinë e Financave të Republikës së Serbisë.

Në periudhën në vijim janë planifikuar trajnime e seminare me synimin për të edukuar individët se si të aplikojnë në fondet e IPA-s e të realizojnë projekte konkrete.



Rajoni i ERSUS



Të Punojmë së Bashku Drejt të Njëjtit Synim: IPA CBC të Sukseshme në Ballkanin Perëndimor!

Në qershor 2006, detyra kryesore si e CBIB, edhe e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ishte krijimi i bazës për bashkëpunim ndërkufitar që do të ndodhte për herë të parë në kufijtë e brendshëm të Ballkanit Perëndimor në kuadrin e instrumentit të ri financiar të BE-së, IPA.

Në një Rajon të ndryshueshëm, me nivel të ndryshëm përvojash në kuadrin e CBC, sigurisht që kjo përbënte një sfidë të vërtetë!

Gjithsesi, me drejtimin e qëndrueshëm të Komisionit dhe të Delegacioneve e zyrave të EAR në Rajon, me një bashkëpunim të plotë me Autoritetet Kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe me aktorë të tjerë të përfshirë në proces, mekanizmi i IPA CBC u vu në lëvizje dhe procesi është duke ecur përpara me sukses!



Programimi ishte faza e parë e rëndësishme që u krye nga dhjetori 2006 deri në qershor 2007. Pas 60 takimesh dypalëshe, të mbështetur si nga CBIB edhe nga ekipet kombëtare të TA (Asistencën Teknike), 7 workshop-esh dhe një Forumi Rajonal mbajtur në Zagreb në mars 2007, që u organizuan nga CBIB, u finalizuan tetë programe ndërkufitare në kuadrin e IPA-s ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe iu parashtruan Komisionit Evropian më 31 maj 2007. Komisionit Evropian miratoi të gjitha programet në dhjetor të po të njëjtit vit.



Fushata e Ndërgjegjësimit: Prezantimi i IPA CBC në Ballkanin Perëndimor



Banja Luka, 18.04.2008



Bihać, 11.12.2007



Brčko, 13.12.2007



Elbasan, 27.07.2007



Mostar, 22.11.2007



Kukes, 26.10.2007



Nikšić, 02.04.2008



Podgorica, 25.12.2007



Šabac, 27.03.2008

Dhënia e informacionit të duhur në kohën e duhur është thelbësore për çdo lloj sipërmarrjeje me qëllim që ajo të ketë sukses. Me synimin për të ndikuar sa më shumë Aplikantë Potencialë të IPA CBC në të ardhmen me informacionin e duhur për programet dhe fondet e disponueshme, në bashkëpunim me Autoritetet Kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor, aktorë të ndryshëm lokalë e rajonalë të CBIB organizuan një fushatë ndërgjegjësimi që u krye nga qershori 2007 deri në maj 2008. 1600 pjesëmarrës ndoqën 25 evenimente në 6 vende të Rajonit.



Priştina, 23.10.2008



Tuzla, 19.03.2008



Dibra, 24.08.2007

Evenimenti që kurorëzoi të gjithë fushatën ishte seminari ndërkufitar i organizuar në Visegrad, Bosnjë dhe Hercegovinë, me 180 pjesëmarrës nga 3 vende: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia.

Ky seminar provoi interesin e madh të treguar me synimin për të zgjidhur problemet e përbashkëta e për të krijuar sinergji nëpërmjet projekteve ndërkufitare!

Višegrad, 20.05.2008



Forcimi i Kapaciteteve për Zbatimin dhe Menaxhimin e Suksesshëm të Programit



Skopje, 18.-19.04.2007



Podgorica, 31.10.-1.11.2007



Sarajevo, 5.-6.12.2007



Tirana, 17.-18.01.2008



Pristina, 19.-20.03.2008



Kotor, 29.09.-02.10.2008



Skopje, 7.-10.10.2008

Me qëllim që programet të bëhen plotësisht operative e rrjedhimisht të suksesshëm, janë të nevojshme ngritja e stafit të duhur e të trajnuar të Strukturave Operative e Strukturave të Përbashkëta të Menaxhimit (Komitetet e Përbashkëta të Monitorimit e Sekretariatet e Përbashkëta të Monitorimit). Duke pasur këtë në mendje, CBIB fillimisht ndërmoi një sërë trajnimesh për përfaqësuesit e Autoriteteve Kombëtare që do të përfshihen drejtpërdrejtë në menaxhimin dhe zbatimin e programeve. Në të njëjtën kohë, Forumi i 2të Rajonal Konsultativ, i organinuar nga CBIB në Shkup në qershor 2008, ishte mundësia për të gjithë ata që ishin të përfshirë drejtpërdrejtë në IPA CBC në Ballkanin Perëndimor për të marrë përgjigjet ndaj pyetjeve që kishin të bënin me menaxhimin dhe zbatimin e programeve nëpërmjet diskutimeve të hapuara e kontakteve të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e Komisionit Evropian. CBIB gjithashtu ka mbështetur në mënyrë aktive procesin e krijimit të strukturave të përbashkëta. Që nga nëntori 2007 janë mbajtur 30 takime dypalëshe e strukturat janë ngritur. U mbajtën tre seminare trajnimi 4 ditor për stafin e caktuar të JTS dhe Antenës gjatë shtatorit e tetorit 2008, me qëllim për t'i përgatitur ata për Thirrjet për Propozime që do të lançohen së shpejti.



Forcimi i Kapaciteteve për Përgatitje të Sukseshme të Projekteve

Me përgatitjen dhe miratimin e programeve dhe me vendosjen e strukturave të menaxhimit, CBIB ndërmori një detyrë të rëndësishme për të përgatitur ata që do të jenë përfituesit përfundimtarë potencialë të fondeve të IPA CBC që të marrin pjesë me sukses në thirrjen për propozime që do të lançohet së shpejti. Pasi aplikantët potencialë u informuan për mundësitë e financimit në bazë të IPA CBC gjatë fushatës së ndërgjegjësimit, CBIB organizoi 18 sesione 2 ditore trajnimi për rreth 600 aplikantë potencialë në Rajon.



Nën syrin e kujdesshëm të trajnuesve . . .



. . . nëpërmjet punës në grup dhe konsultimeve . . .



. . . nëpërmjet shkëmbimesh dhe diskutimesh . . .



. . . pak me hezitim dhe pasiguri . . .



. . . dhe me ndihmën e një 'kali të lumtur (rasti demonstrues në trajnime)' . . .



. . . të gjithë ia dolën mbanë me sukses në fund . . .



. . . gati për sfidat e Thirrjeve për Propozime që shpejt do vijnë!





Natasa Gospodjinacki,
Drejtuere e Ekipit

"Menaxhimi i një projekti Rajonal ka qenë një detyrë e vështirë, delikate dhe komplekse. Është bërë shumë punë, janë kaluar orë të tëra në punë, mijra kilometra mbeten pas, faqe e faqe të tëra dokumentesh janë përgatitur, ka pasur shumë arritje të rëndësishme, por ende mbetet punë për të bërë pasi nuk ka mbaruar. Ekipi i CBIB, i përbërë nga individë me profesionalizëm të lartë e me aftësi për të kryer detyrat, ka shkuar përtej "përshkrimit të punës" të caktuar dhe, në më pak se dy vjet, është bërë një "familje", në të cilën ne jemi më shumë se kolegë, jemi miq që mbështesin njëri tjetrin në punë, por edhe në jetën private. Ju falënderoj për besimin tuaj, për përkushtimin dhe punën e madhe dhe për të siguruar që arritjet të ishin jo vetëm personale, apo në lidhje me projektin, dhe se nuk janë ndërmarrë si detyra individuale, por së bashku. Duke bërë kështu, ju keni kontribuar në mirëqënien e atyre që synon projekti, individët në secilin vend, të cilët bashkarisht ndanë me ne hezitimet, punën dhe ëndrrat dhe duke besuar tek ne, janë ata që e bënë të vlefshme punën e përpjekjet tona. Për mua, në fundin e Fazës 1 të CBIB, mundësia për të punuar me një ekip kaq të mirë, me njerëz në institucione e me ata që janë përfshirë në veprimtaritë tona në secilin vend, ishte një nder i madh, një përvojë që ndodh një herë në jetë për të cilën e di se është unike, por që unë do të dëshiroja të zgjaste përgjithmonë."



Sotirag Guga,
Ekspert Kryesor, Shqipëri

"Ka qenë një përvojë e madhe të punoj për të bashkuar njerëzit në një Rajon historikisht të ndryshëm. Ne besojmë tek njerëzit, vetëm së bashku ata mund të bëjnë kufijtë të mos ekzistojnë më..."



Remy Reymann,
Ekspert Kryesor, Ish-Republika
Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi

"Ishte një mundësi e jashtëzakonshme mundësia për të takuar e punuar me individë nga i gjithë Ballkani Perëndimor e për tu ndjerë pjesë e një rrjeti që do të jetojë shumë më tepër se një projekt si CBIB. Pjesëmarrja në fillimin e aventurës së IPA CBC ka qenë një ndjesi entuziazmi, që ndahet nga shumë të tjerë."



Haris Pijnjac,
Ekspert Kryesor, Bosnja dhe Hercegovina

"Duke zbatuar Programet e CBC ne nuk ndihmojmë vetëm njerëzit në nevojë, por edhe vendosim një tjetër mozaik në të tërën, që ndihmon këndvështrimet pozitive ndaj BE-së në këtë rajon dhe ndihmon në hapjen e dyerve për Shtete të reja Anëtare. Mbështetja e këtij procesi dhe të qënurit pjesë e CBIB ka qenë një përvojë dhe nder i papërsëritshëm."



Jasminka Taseva-Jankovic,
Eksperte Lokale, Ish-Republika
Jugosllave e Maqedonisë

"IPA CBC nënkupton shumë punë si për të kuptuar politikat që kanë lidhje me BE-në, edhe për të gjetur gjuhën e terminologjinë e transferimin e këtyre njohurive tek stafi i Autoriteteve Kombëtare dhe i aplikantëve potencialë. Ky është vetëm fillimi; puna e vërtetë vjen me daljen e Thirrjes së parë për Propozime."



Alda Duraji,
Eksperte Lokale, Shqipëri

"Ishte përvoja më e vlefshme që kam pasur përsa i përket profesionalizmit dhe punës si ekip, si në kontekstin vendas, edhe në atë rajonal. Jam e sigurt se ajo do të reflektohet në çdo sipërmarrje tjetër në të cilën do të angazhohem."



Marijana Ivanova,
Eksperte Lokale, Mali i Zi

"CBC është një sfidë e vërtetë në SEE. Të bësh njerëzit të mendojnë përtej kufijve – ata real dhe ata që ekzistojnë në mendjet e tyre – është një gjë shumë e rëndësishme për këtë rajon. Unë jam e lumtur që jam pjesë e këtij procesi që mund të përshpejtojë progresin dhe mirëqënien e të gjithë rajonit, si dhe integrimin e tij në BE."



Marija Stevanovic,
Eksperte Lokale, Serbi

"Në këto 29 muaj janë bërë hapa të vegjël për të gjithë ne, por hapa gjigandë për Rajonin."



Maja Stojanovic,
Eksperte Lokale, Serbi

"Gjatë punës sime në CBIB, jo vetëm që kam punuar me njerëz nga i gjithë Rajoni, por edhe kam mësuar shumë më tepër për IPA CBC. Më e rëndësishmja është që kam bërë miq dhe me këtë rast dëshiroj të falënderoj kolegët e mi, veçanërisht ekipin e CBIB nga Beogradi për mbështetjen dhe durimin e tyre. Shumë punë e mirë nga të gjithë!"



Milena Milovic Blagojevic,
Eksperte Lokale, Serbi

"Ishte privilegj të qënurit dëshmitare të një procesi që ka tërhequr kaq shumë impulse pozitive në të gjithë Rajonin. Unë shpresoj që sinergjitë e krijuara në të gjitha nivelet të vazhdojnë të ekzistojnë e të sjellin përfitime për të gjithë."



Eleonora Matov,
Menaxhere Zyre, Shkup

"Çdo projekt i suksesshëm ka një histori të dhimbshme pas, dhe çdo histori e dhimbshme ka një fund të suksesshëm. Ne e pranuem sfidën dhe u bëmë gati për sukses. Të qënurit pjesë e mozaikut të Ballkanit Perëndimor është një aventurë sfiduese që çdokush duhet ta përjetojë."



Teofana Mitrovic,
Menaxhere Zyre, Sarajevë

"CBIB me sukses ia ka dalë mbanë të japë ndihmën që kaq shumë nevojitej për vendet e Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE, duke promovuar respektin ndërkulturor dhe tolerancën në të njëjtën kohë. Të qënurit pjesë e këtij ekipi ishte një përvojë unike dhe e vlefshme."



Fredi Bejleri,
Menaxhere e Zyres, Tirana

"Mozaiku i IPA CBC mbart një pikturë të bukur të punës sonë."



Olivera Milutinovic,
Menaxhere Zyre, Beograd

"Ndonjëherë ndihesh sikur je në një mision të pamundur, me kaq shumë ndryshime e kaq shumë hallka për t'i kapërcyer ato...Ballkani është i vështirë për tu kuptuar, por kjo e bën atë aq të përzisueshëm – gjithmonë ju jep shumë arsye për të besuar."



Dragoslav Pejanovic,
Office Assistant, Beograd


"Të qënurit pjesë e një ekipi kaq dinamik ka qenë një përvojë e vlefshme që sigurisht do të jetë e dobishme në të ardhmen."



Ja se si filloi e gjithë kjo . . .



. . . dhe pastaj . . .



Problemet që na bashkonin

U parashtruan me përpjekje të përbashkëta dhe

U zbatuan nëpërmjet CBC duke sjellë

Përfitime për të gjithë Rajonin!

. . . por . . .

kjo është vetëm pjesa e parë e mozaikut kompleks të IPA CBC dhe sfidat e mëdha janë ende përpara nesh të gjithëve!

